

Kartela paralajmëruese e pacientit



Xanirva 20 mg

Mbajeni kartelën me vete në çdo kohë

Tregojani këtë kartelë secilit mjek ose dentisti para trajtimit

Unë jam nën trajtim antikoagulues me Xanirva (rivaroksaban)

Emri:

Adresa:

Ditëlindja:

Pesha

Barnat/gjendjet tjera:

Në rast emergjence, ju lutemi njoftoni:

Emri i Mjekut:

Numri i telefonit të Mjekut:

Faksimili i Mjekut:

Ju lutemi njoftoni edhe:

Emri:

Telefoni:

Marrëdhënia:

Informacion për ofruesit e kujdesit shëndetësor:

- Vlerat e INR nuk duhet të përdoren pasi ato nuk janë një masë e besueshme e aktivitetit antikoagulant të **Xanirva**.

Çfarë duhet të di rreth Xanirva?

- Xanirva e hollon gjakun, gjë që parandalon formimin e trombeve të rrezikshme të gjakut.
- Xanirva duhet të merret saktësisht siç ju ka përshkruar mjeku juaj. Për të siguruar mbrojtje optimale nga trombet e gjakut, **mos e anashkaloni kurrë një dozë**.
- Nuk duhet të ndërprisni marrjen e Xanirva pa u konsultuar më parë me mjekun tuaj, pasi rreziku i trombeve të gjakut mund të rritet.
- Njoftoni ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor për çdo bar tjetër të cilin jeni duke e marrë aktualisht, e keni marrë së fundmi ose keni ndërmend të filloni ta merrni, përpara se të filloni Xanirva.
- Njoftoni ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor se po merrni Xanirva përpara çdo ndërhyrjeje kirurgjikale ose procedure invazive.

Kur duhet të kërkoj këshilla nga ofruesi im i kujdesit shëndetësor?

Kur merrni një hollues gjaku siç është Xanirva, është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm për efektet anësore të mundshme. Gjakderdhja është efekti anësor më i shpeshtë. Mos filloni të merrni Xanirva nëse e dini që jeni në rrezik për gjakderdhje, pa e diskutuar më parë këtë me mjekun tuaj. Njoftoni menjëherë ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor nëse keni ndonjë shenjë ose simptomë të gjakderdhjes, siç janë më poshtë:

- dhimbje
- ënjtje ose shqetësim
- dhimbje koke, marramendje ose dobësi
- mavijosje të pazakonshme, gjakderdhje nga hunda, gjakderdhje nga mishrat e dhëmbëve, prerje që kërkojnë shumë kohë për të ndaluar gjakderdhjen

- rrjedhje menstruale ose gjakderdhje vaginale që është më e rëndë se normale
- gjak në urinën tuaj që mund të jetë rozë ose kafe, jashtëqitje të kuqe ose të zeza
- kollitje me gjak, ose të vjella me gjak ose materiale që duken si kokrra të kafes

Si ta merrni Xanirva

- Për të siguruar mbrojtje optimale, Xanirva 20 mg duhet të merret me ushqim

Burimet e dokumentit Global:

- SmPC – for film-coated tablets (CZ/H/0834-0835) and hard capsules (CZ/H/0836-0837) approved 29-Apr-2022.
- RMP – version 2.0 for film-coated tablets (CZ/H/0834-0835, approved 28-Aug-2022) and version 1.2 for hard capsules (CZ/H/0836-0837, approved 22-Mar-2022)
- Educational material of the reference product Xanirva:
 - Patient alert card (Jan-2019)